



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 189, datë 27.11.2025

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS SË “BANKA OTP ALBANIA” SH.A., PËR HEQJEN E LICENCËS PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË AGJENTIT NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 201, të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

“Banka OTP Albania” sh.a., është e licencuar për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime, për klasat e jojetës, në emër dhe për llogari të shoqërive të sigurimit “Albsig” sh.a dhe “Intersig VIG” sh.a. Me vendimet e Bordit nr. 45/2022 dhe nr. 130/2022, “Banka OTP Albania” sh.a. është licencuar për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime, në klasat e jojetës, në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimeve “Atlantik” sh.a. dhe “Sigal Uniqa Group Austria” sh.a.

Aktualisht “Banka OTP Albania” sh.a. mban licencën nr. 1078/3, datë 30.06.2022 “Për ushtrim veprimtarie agjent në sigurime”, për klasat e jojetës, në emër e për llogari të shoqërive të sigurimit “Albsig” sh.a., “Intersig VIG” sh.a., “Atlantik” sh.a. dhe “Sigal UGA” sh.a.

“Banka OTP Albania” sh.a., ka kërkuar heqjen e licencës për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime, për arsye se mban edhe licencën nr. 28, datë 28.07.2023, miratuar me vendimin nr. 134, datë 28.07.2023, për ushtrimin e aktivitetit si broker në sigurime për klasat e jetës dhe jojetës.

Përsa më sipër, në mbështetje të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 201, të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe kërkesës së vetë subjektit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “Banka OTP Albania” sh.a., për heqjen e licencës nr. 1078/3, datë 30.06.2022 “Për ushtrim veprimtarie agjent në sigurime”, për klasat e jojetës, në emër e për llogari të shoqërive të sigurimit “Albsig” sh.a., “Intersig VIG” sh.a., “Atlantik” sh.a. dhe “Sigal UGA” sh.a.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Saimir TOLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Mimoza KAÇI